

Me bekimin e Mitropolitit të Beratit, Vlorës dhe Kaninës, Imzot Ignatit, Këshilli Kishtar i Beratit, ka çelur një fushatë mbledhje fondesh, për restaurimin dhe kthimin sa është e mundur në identitet, të kishës historike të Shën Marisë së Ujërave në lagjen Mangalem



Një prej monumenteve më të vecanta historike në Berat është edhe Kisha e Shën Marisë së Ujërave. Dëmtimet e herë pas hershme ka bërë që tashmë të nis një fushatë për mbledhjen e fondeve, ku besimtarë dhe dashamirës mund të kontribuojnë për restaurimin e mbetjeve të kishës. Pasi përfunduan disa punime paraprake, qëllimi është që të kthehet aty sa është e mundur kujtimi dhe madhështia i këtij monumenti të famshëm.

